



REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE
MINISTRY OF JUSTICE

Nr.Br.No: 01-1611
Data / Datum / Date: 01 / 12 / 2009
Shtojca / Dodaci / Annex _____
PRISHTINË, A

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVO
MINISTRIA E DREJTËSISË / MINISTARSTVO PRAVDE / MINISTRY OF JUSTICE

SHËRBI I KORREKTIVS I KOSOVËS - KOREKTIVNA SLUŽBA KOSOVA
KOSOVO CORRECTIONAL SERVICE

Nrësia org/Org, Institutional/Org, Unit: _____
06 Nr./No./No. 2032 Data/Datum/Date: 09 / 12 / 2009
Shtojca/Dodaci/Annex _____
PRISHTINË, A

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Ministrja e Drejtësisë, në mbështetje të nenit 92, pika (4), nenit 93 pika (4), nenit 145 pika (2) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 25 pika (7) të Rregullores për Punën e Qeverisë, të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2001/19 "Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë" neni 1.3 nën (ç), 1.6 dhe 1.7, të ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2005/53 të datës 20 dhjetor 2005 si dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2006/26 të datës 27 prill 2006, si dhe zbatimin e neneve 42 - 46, 48, 49, 50, 53. të Ligjit mbi Ekzekutimin Sanksioneve Penale, Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2004/46 e datës 19 nëntor 2004; Rregullorja e UNMIK-ut 2004/34 mbi procedurën penale ku përfshihen kryesisht me çrregullime mendore. nxjerr;

**UDHËZIM ADMINISTRATIV PËR OFRIMI I SHËRBIMEVE MJEKSORE NE
INSTITUCIONET KORREKTUESE**

Neni 1
Qëllimi

Të sigurohet që të burgosurit të kenë qasje në shërbime shëndetësore .

Neni 2

Mbrojtja mjekësore

2.1 Të gjitha burgjet sigurojnë shërbime themelore mjekësore, shërbimin e përkujdesjes dhe shërbimet farmaceutike.

2.2 Tretmani primar mjekësor për të burgosurit duhet të zhvillohet në burg.

2.3 Kur është e pamundur t'i ofrohet tretman i duhur mjekësor, I burgosuri do të dërgohet në ndonjë spital tjetër të burgut ose spital të jashtëm, ku mund t'i ofrohet tretmani mjekësor.

2.4 Të burgosurit kanë të drejtë në përkujdesje shëndetësore falas.

2.5 I burgosuri mund të kërkoj nga Drejtori I burgut mendimin tjetër mjekësor. Nëse ipet leja nga drejtori I burgut, shpenzimet për mendimin e dytë mjekësor I bart I burgosuri, përveç nëse drejtori I burgut vendos ndryshe.

2.6 Kujdesi shëndetësor ofrohet me ekzaminime periodike dhe të shpeshta, pavarësisht se a e ka parashtruar I burgosuri kërkesën. Koha e duhur konsiderohet një herë në muaj.

2.7 Nëse I burgosuri rrezikohet te vuaj nga probleme te renda shëndetësore ose nga vdekja, merren masa qe atij t'i ofrohet trajtimi me i mire i mundshëm.

2.8 Nëse e burgosura është shtatzënë, duhet të bëhen përgatitjet që kurdo që është e mundur, fëmija të lind në spitalin publik. Nëse fëmija lind në qendër korrektuese, ky fakt nuk do të cekët në certifikatën e lindjes.

2.9 Të dhënat mjekësore të të burgosurit trajtohen si sekrete në pajtim me praktikën profesionale mjekësore dhe kodin e etikës mjekësore.

2.10 Punëtori shëndetësor-Mjeku, është përgjegjës që të njoftoj Drejtorin e burgut dhe Drejtorin shëndetësore nëse mendon se gjendja fizike ose psikike e të burgosurit është keqësuar ose do të keqësohet nga qëndrimi I vazhdueshëm ose burgimi afatgjatë ose nga kushtet në të cilat ai jeton.

Neni 3

Njoftimi familjes

3.1 Kur I burgosuri është i sëmurë shume rëndë, familja e tij e ngushtë do të njoftohet menjëherë nga drejtori. Ky njoftim do të dokumentohet në formë të duhur.

3.2 I burgosuri mundet po ashtu të kërkoj që personat shtesë të njoftohen për sëmundjen e tij/saj.

Neni 4

Inspektimi

Mjeku, në bashkëpunim me organin vendor shëndetësor, do të zhvilloj inspektimin e burgut një herë në muaj dhe me shkrim do ta njoftoj Drejtorin e burgut për:

- a Sasinë, cilësinë, përgatitjen dhe shërbimin e ushqimit dhe ujit;
- b Higjienën dhe pastërtinë e burgut dhe të burgosurve;

- c Kanalizimi, ngrohja, ndriçimi dhe ventilimi I burgut; dhe
- d Përshtatshmërinë e pastërtisë së veshmbathjes dhe shtresave e mbulesave.
- e Te gjitha qeshtjet tjera rregullohen me direktiva te Udhëheqësit shëndetësor.

Neni 5

Shërbimet psikiatrike

- 5.1 Shërbimet psikiatrike konsiderohen si shërbime mjekësore dhe konsiderohen si e drejtë e paraparë në Rregulloren 2004/34
- 5.2 Nëse personi i dënuar ka nevojë për shërbimet e njësisë së specializuar mentale, ato zakonisht duhet të ofrohen në Institucionin e shëndetit mendor përkatës.
- 5.3 Nëse I burgosuri ka nevojë për kujdesin e posaçëm psikiatrik, ai kujdes do t'i ofrohet në repartin psikiatrik me sigurim që gjendet në Spitalin Psikiatrik civil.
- 5.4 Shëndeti publik do të siguroj mjekimin e detyrueshëm psikiatrik te burgosurve, të shqiptuar nga gjykata dhe nuk do të ekzekutohet në burgje, përfshirë Njësinë Psikiatrike të burgut (Rregullorja nr. 2004/34, seksioni 16.1).
- 5.5 Mbikëqyrja e psikiatrisë forenzike dhe vlerësimi zhvillohen nga ana e Shërbimit të Shëndetit Publik në kuadër të Spitaleve Publike.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi ditën e nënshkrimit .

Prishtinë: 25.11.2009

Ministre e Drejtësisë

Nekibe Kelmendi
Ministre

